



# MBLEDHJA JOFORMALE E MBETURINAVE DHE RECIKLIMI

Prill, 2019



## Mirënjohje

Anëtarët e Koalicionit dëshirojnë të falënderojnë të intervistuarit nga institucionet dhe organizatat e ndryshme për gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë dhe të japin informacione dhe të dhëna të paçmueshme për këtë raport.

## OJQ-ja udhëheqëse për publikimin e Raportit

ECMI Kosovo ([www.ecmikosovo.org](http://www.ecmikosovo.org))

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare që merret me çështjet e minoriteteve në Kosovë, me qëllimin e përgjithshëm për të zhvilluar institucione përfaqësuese, përfshirëse dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, dhe që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumë-etnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, përkrah institucionalizimin e organeve qeveritare që kanë të bëjnë me komunitetet, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për të punuar me njëri-tjetrin në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.

Rruga "Nëna Terezë" Nr. 20, Apt. 5,  
10000 Prishtinë—Kosovë,  
Tel. +383 (0) 38 224 473

Rruga "Kralja Petra" 183a  
38220 Mitrovicë e Veriut—Kosovë

## Koalicioni për të drejta të barabarta për të gjithë - ERAC

ERAC mbledh së bashku shtatë (7) OJQ që punojnë *në fushën e sundimit të ligjit dhe të të drejtave themelore*, të cilat punojnë së bashku me **19 OJQ**, me fokus në ngritjen e një rrjeti të qëndrueshëm të OJQ-ve, që janë aktive në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore të grupeve të rrezikuara dhe/ose të marginalizuara. Fokusi specifik i projektit janë këto grupe: **komunitetet jo-shumicë, gratë, rinia, dhe komuniteti LGBT**. Edhe pse punojnë apo shtrijnë veprimet e tyre në tema dhe çështje të ngjashme, këtyre OJQ-ve u mungon bashkëpunimi dhe shpesh përqendrimi i punës së tyre është i ndarë në bazë të grupeve të veçanta të synuara, me të cilat punojnë ato, apo i ndarë sipas rajoneve ku ato shtrijnë aktivitetet e tyre. Me krijimin e një bashkëpunimi strukturor në mes të OJQ-ve të përzgjedhura dhe me ofrimin e mundësive formale për mësim të vazhdueshëm, veprimi gjeneron shkëmbimin e njohurive dhe përvojës në mes të OJQ-ve (duke përfshirë përvojën në çështjet institucionale), për të forcuar kapacitetet e tyre për avokim me institucionet qendrore dhe komunale, dhe për të rritur dukshmërinë e tyre në terren.

Anëtarë të ERAC-ut janë organizatat si më poshtë:

- Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë –Organizatë lider e Koalicionit;
- Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore– anëtare e Koalicionit;
- Qendra për Barazi dhe Liri të komunitetit LGBT në Kosovë (CEL) – anëtare e Koalicionit;
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore - anëtare e Koalicionit;
- Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - anëtare e Koalicionit;
- Kosovo 2.0 – anëtare e Koalicionit;
- Qendrën për Ndhimë Juridike dhe Zhvillim Rajonal (CLARD) - anëtare e Koalicionit

## Klauzolë e përgjegjësive

Ky publikim është botuar me mbështetje financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e ECMI Kosovo dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

## E drejta e autorit

© Koalicioni të drejta të barabarta për të gjithë (ERAC), prill 2019. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem të rikthimit ose të transmetohet në asnjë formë ose me çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik, foto-kopjimi, regjistrimi ose ndryshe, pa lejen paraprake të ERAC-ut.



# **MBLEDHJA JOFORMALE E MBETURINAVE DHE RECIKLIMI**

Prill, 2019



## **TABELA E PËRMBAJTJES**

<b>1. Hyrje.....</b>	<b>7</b>
<b>2. Situata e grumbullimit të mbeturinave në Kosovë.....</b>	<b>10</b>
2.1 Korniza ligjore dhe institucionale për grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave.....	10
2.1.1 Institucionet qeveritare në nivelin qendrorë dhe kompetencat në menaxhimin e mbeturinave.....	10
2.1.2 Strategjia qendrore dhe plani për menaxhimin e mbeturinave.....	12
2.1.3 Kompetencat Komunale në menaxhimin e mbeturinave.....	13
2.1.4 Institucionet tjera publike që merren me menaxhimin e mbeturinave..	14
2.2 Reciklimi.....	15
2.3 Vështirësitë në menaxhimin formal të mbeturinave dhe roli i mbledhësve joformalë të mbeturinave.....	16
<b>3. Kushtet e punës dhe të drejtat themelore të mbledhësve joformal të Meturinave.....</b>	<b>17</b>
3.1 Situata e grumbulluesve joformal të mbeturinave.....	17
3.2 Problemet shëndetësore dhe siguria në punë.....	18
3.3 Mungesa e paisjeve.....	19
3.4 Të ardhura të vogla.....	20
3.5 Punësimi i fëmijëve.....	22
<b>4. Kontributi i shoqërisë civile në adresimin e çështjes së grumbullimit joformal të mbeturinave.....</b>	<b>25</b>
<b>5. Çështjet e vazhdueshme.....</b>	<b>27</b>
<b>6. Mundësitë ekonomike të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë.....</b>	<b>28</b>
6.1 Masat për të përmirësuar reciklimin dhe të e mbrojmë ambientin.....	28
6.2 Mundësitë e reja për grumbulluesit joformal të mbeturinave që mund të bëhen pjesë e Ndërmarrjeve Sociale në Kosovë.....	29
<b>7. Përfundimet dhe Rekomandimet.....</b>	<b>34</b>
7.1 Përfundimet.....	34
7.2 Rekomandime për krijimin e reformave për sektorin e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë.....	35
<b>8. Referencat.....</b>	<b>38</b>

## **ABSTRAKT**

Ky raport synon të ofrojë një përshkrim të sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë, veçanërisht duke u fokusuar në rolin e 'mbledhësve joformalë të mbeturinave' dhe jep detaje të situatës së grumbullimit të mbeturinave në Kosovë. Më pas shpjegon rrethanat, vështirësitë dhe shkeljet e të drejtave të njeriut që hasin grumbulluesit joformalë të mbeturinave. Në fund, ky raport jep një numër rekomandimesh për të përmirësuar industrinë e grumbullimit të mbeturinave në Kosovë dhe se si të dalin grumbulluesit joformalë të mbeturinave nga varfëria dhe të respektohen të drejtat e tyre si qytetarë. Këto rekomandime gjithashtu janë të bazuara në përvojat e ECMI Kosovës dhe organizatave tjera që punojnë në këtë sektor.

## 1. HYRJE

Ky raport synon të ofrojë një përmbledhje të sistemit joformal të grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave në Kosovë, duke u fokusuar veçanërisht në rolin e mbledhësve joformalë të mbeturinave dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut me të cilat ata përballen. Së pari, raporti përshkruan situatën e grumbullimit të mbeturinave në Kosovë në mënyrë formale dhe joformale në nivelin lokal dhe qendror. Më pas, raporti fokusohet specifikisht në pozitën të cilën ndodhen grumbulluesit joformalë të mbeturinave, duke marrë parasysh jo vetëm rolin e tyre në sistemin e grumbullimit të mbeturinave në tërësi, por edhe në rrethanat e tyre individuale dhe abuzimin që atyre u bëhet si qenie njerëzore. Veprimet e ndërmarra në këtë fushë për të mbështetur mbledhësit jofomale të mbeturinave nga disa organizata duke e përfshirë ECMI Kosovën, Swiss Contact, GIZ janë të shpjeguara në detaje. Gjithashtu, veprimet të cilat duhet të ndërmirren për të vazhduar për të përmirësuar këtë situatë janë të sygjeruara duke u bazuar në nevojat e personave të përfshirë në këtë çështje dhe duke u bazuar në përvojën e ECMI Kosovës dhe organizatave tjera që punojnë në këtë sektor.

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë është disi i komplikuar, ku janë të përfshirë akterë të shumtë të cilët bëjnë grumbullimin e mbeturinave në mënyrë formale dhe joformale. Në nivelin qendrorë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor (MMPH) ka për detyrë rregullimit e legjislacionit primarë dhe sekondarë dhe organizimin e kornizës së përgjithshme ligjore që prek këtë çështje. Në nivelin lokal, kompanitë regjionale për grumbullimin e mbeturinave i mbledhin ato nga konteniere privat dhe publik, dhe i transportojnë tek qendrat e mëdha të grumbullimit të mbeturinave të njohura edhe si "deponi".

Paralelisht me strukturat formale, Kosova gjithashtu ka një industri joformale të konsiderueshme të grumbullimit të mbeturinave e cila është e shtrirë në të gjithë vendin. Shumica e akterëve të përfshirë në këtë industri janë grumbulluesit individual joformalë të mbeturinave, të cilët kryesisht janë pjesëtarë të grupeve të marginalizuara dhe ndjeshme. Këta individë punojnë në kushte të vështira dhe të rrezikshme të cilët marrin kompenzim të vogël për të bërë këtë punë. Ata mbledhin mbetjet që konsiderohen të vlefshme nga vende të ndryshme ku hudhen mbeturinat dhe i transportojnë dhe shesin tek kompanitë vendore private. Këto kompani janë kompani të vogla të mesme të cilat zakonisht, por jo gjithmonë, janë të licensuara nga MMPH për angazhimin e tyre në menaxhimin e mbeturinave, të cilat më pas i shesin mbetjet e reciklueshme tek kompanitë më të mëdha jashtë vendit. Eksportimi i mbeturinave të reciklueshme në fakt përbën pjesën më të madhe të eksportit të tregut të Kosovës. Në Kosovë nuk ka sistem publik të reciklimit; rrjedhimisht, për të bërë këtë, shteti për të mbushur këtë boshllëk, varet nga kompanitë private,

organizatat e shoqërisë civile dhe më së shumti nga grumbulluesit joformal të mbeturinave.

Ky raport gjithashtu fokusohet tek çështja e të drejtave themelore të njeriut, në këtë rast të mbledhësve joformal të mbeturinave, të cilët punojnë në kushte të rrezikshme dhe të parregulluara sepse janë në nevojë dhe nuk mundën të gjejnë vend pune në ndonjë industri formale. Personat që punojnë si mbledhës joformal të mbeturinave nuk kanë ndonjë license për të bërë këtë punë, kështu që nuk figurojnë as nuk janë të regjistruar askund. Autoritetet e Kosovës janë të vetëdijshëm për ekzistencën e tyre si grup por jo edhe të individëve të përfshirë. Për të i mbështetur familjet e tyre të cilat kanë kushtet të vështira ekonomike, grumbulluesit joformal të mbeturinave punojnë në kushte shumë të vështira në mungesëtë mjeteve adekuate transportuese dhe mungesë të paisjeve të duhura. ECMI Kosova ka adresuar situatën e mbledhësve joformal të mbeturinave me anë të projektit “Rritja e punësimit të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian përmes reciklimit kolektiv”, I cili ka qenë i financuar nga Bashkimi Evropian dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe është zbatuar nga dhjetori I vitit 2014 deri në dhjetor të vitit 2016. Projekte të ngjashme janë zbatuar edhe nga organizata tjera të shoqërisë civile të cilat punojnë në të gjithë Kosovën. Zbatimi i të gjitha projekteve që kanë adresuar këtë çështje ka sjellë rezultate shumë positive, mirëpo problem kryesor thuhet të jetë qëndrueshmëria e këtyre veprimeve në afatgjatë.

Identifikimi I numrit të sakt të mbledhësve joformal të mbeturinave është shumë i vështirë për shkak që, siç e përmendur më lartë, statusi I tyre nuk është I regjistruar askund, mënyra e punës së tyre nuk është e rregullt dhe shumë prej tyre ngurrojnë të bashkëpunojnë me autoritetet shtetërore. Megjithatë, është e padiskutueshme që veprimet e marra nga Qeveria e Kosovës dhe institucionet përgjegjëse, si dhe organizatat e shoqërisë civile, kanë ndikim pozitiv jashtëzakonisht të madhë në punën e përditshme të tyre e edhe në mënyrën e jetesës së tyre. Duke marrë parasysh vështirësitë që këta persona hasin, veprimet e ndërmarra përmirësojnë kushtet socio-ekonomike të tyre dhe do të i mbështesin të integrohen në shoqërinë Kosovare.

Ky raport është bërë duke u përdorur metoda kualitative dhe kuantitative me qëllim që të sigurojmë një pasqyrë të plotë të sistemit të grumbullimit të mbeturinave në Kosovë dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut që u bëhet personave të përfshirë. Gjatë përpilimit të këtij raporti, janë konsultuar dokumente të publikuara deri më tani të cilat kanë prekur këtë çështje, janë marrë parasysh statistika ekzistuese, janë bërë vizita në teren ku janë bërë intervista me individë të cilët janë të angazhuar si grumbullues joformal të mbeturinave, gjithashtu janë bërë takime me akterë përgjegjës të të gjitha niveleve, duke përfshirë autoritetet komunale dhe publike, organizatat e shoqërisë civile, dhe akterë tjerë relevant. Raporti gjithashtu e merr



parasysh edhe sondazhin e kryer në mes të janarit dhe shkurtit të vitit 2015 I cili përfshin 120 pjesëmarrës të cilët janë grumbullues joformal të mbeturinave në pesë (5) komuna të Kosovës.

Ky raport në fund gjithashtu sygjeron të ndërmerren veprime të cilat kontribuojnë në forcimin dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit aktual të grumbullimit të mbeturinave dhe përmirësimin e kushteve në të cilën punojnë grumbulluesit joformal të mbeturinave në Kosovë. Duke e marrë parasysh gjendjen aktuale, shohim që ka nevojë për ndryshime të caktuara, të cilat janë të prezantuara në formë të rekomandimeve në kapitullin e fundit.

## 2. SITUATA E GRMBULLIMIT TË MBETURINAVE NË KOSOVË


### 2.1 Korniza ligjore dhe institucionale për grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave

Ligji për mbeturinat është burimi kryesor i legjislacionit në Kosovë për përcaktimin e parimeve themelore lidhur me mbeturinat dhe tregon organet e ndryshme qeveritare përgjegjëse për proceset dhe politikat e menaxhimit të mbeturinave. Neni 4 përcakton menaxhimin e mbeturinave si:

aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut, mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe deponimin përfundimtar të mbeturinës, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së këtyre aktiviteteve.<sup>1</sup>

Prioritetet e Kosovës për menaxhimin e mbeturinave janë të listuara në Nenin 5 (5) në Ligjin për Mbeturinat dhe përfshijnë: parandalimi i krijimit të mbeturinave; përpunimi i mbeturinave i cili bëhet me metoda që mundësojnë ripërdorimin e plotë ose të pjesshëm të mbeturinave; riciklimi i mbeturinave; përpunimi dhe shfrytëzimi i mbeturinave; dhe deponimin e mbeturinave (pa shkaktuar ndikime negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut).<sup>2</sup>

#### 2.1.1 Institucionet qeveritare në nivelin qendrorë dhe kompetencat në menaxhimin e mbeturinave



<sup>1</sup> Ligji për mbeturinat Nr.04/L-060; <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2829>

<sup>2</sup> Ibid

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) është organi kryesor qeveritar përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave. Në pajtim me Nenin 14 të Ligjit për Mbeturinat, MMPH kryen një gamë të gjerë të detyrave, të cilat janë: përcaktimi i kornizës ligjore dhe krijimi i politikave lidhur me menaxhimin e mbeturinave; hartimi i planit dhe strategjisë së nivelit qendror për menaxhimin e mbeturinave; dhe licencimi për menaxhimin e mbeturinave i cili bëhet nga Ministri i MMPH të Kosovës. Neni 22 i Ligjit për Mbeturinat thekson që menaxhimi i mbeturinave mund të bëhet nga institucionet apo kompanitë publike dhe private të regjistruara dhe licencuara sipas këtij Ligji. Licencimi mund të refuzohet nëse metodat e përdorura për trajtimin e mbeturinave janë në konflikt me Ligjin për Mbeturinat, veçanërisht kur është fjala për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin. Aplikacioni për të u licencuar për menaxhimin e mbeturinave duhet të dorëzohet tek MMPH i mbështetur me një mori dokumentash dhe certifikatash, siç të specifikuara në Udhëzimin Administrativ të MMPH Nr. 01/2017. Këto dokumenta përfshijnë Lejen Mjedisore Komonale për menaxhim të mbeturinave, certifikatën e regjistrimit të biznesit, certifikatën e numrit fiskal, certifikatën e taksave, planin për menaxhimin e mbeturinave, kualifikimet e dokumentuara të nivelit universitar të një menaxheri teknik dhe një listë të pajisjeve dhe automjeteve të cilat do të përdoren për menaxhimin e mbeturinave. Aplikuesit do të marrin licencë nga MMPH vetëm nëse janë i plotësojnë të gjitha këto kritere. Pasi licenca të jetë dhënë, ajo është e vlefshme për një periudhë pesë (5) vjeçare. Shpenzimet për të marrë licencën për menaxhimin e mbeturinave janë këto: 10 € për të aplikuar për licencë të mbeturinave; 500 € për të marrë një licencë të tillë; 500 € për të bërë kopje të licencës; dhe 200 € për çdo aktivitet tjetër shtesë.

Përveç MMPH, Ministrinë tjera të Kosovës janë përgjegjëse në disa fusha për menaxhimin e mbeturinave. Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) është organi përgjegjës për krijimin e një sistemi të bazës së të dhënave dhe informacionit për menaxhimin e mbeturinave si dhe përpilimin e raporteve për këtë fushë. Ministria e Shëndetësisë (MSH) dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) së bashku me MMPH, janë përgjegjës për rregullimin e menaxhimit të mbetjeve mjekësore. Edhe pse institucionet qeveritare kanë mandate të ndryshme, dhe është e dukshme që ka mjaft vend për përmirësim kur është fjala për komunikim dhe koordinim në mes tyre, secili prej tyre luan një rol të rëndësishëm si institucion përgjegjës në menaxhimin dhe reciklimin e mbeturinave në Kosovë.

Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK) është ndërmarrje qendrore në pronësi publike e cila është themeluar në kuadër të Ligjit Nr. 03 / L-087 për Ndërmarrjet Publike. KMDKudhëheqëkatër (4) deponitë sanitare dhe një stacion transferimi që shërben si pikë e shkarkimit për kompanitë rajonale publike dhe private. Këto deponi janë ndërtuar gjatë administratës së UMNİK-ut nga viti 1999-2008 dhe tani mund të themi që janë në gjendje shumë të keqe dhe disa shumë shpejtë nuk do të mund të përdoren më.<sup>3</sup>

<sup>3</sup>. Agjensioni i Kosovës për mbrojtje nga mjedisi, Raporti Komunal për menaxhimin e mbeturinave, 2018, [https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Municipal\\_Waste\\_Managment\\_in\\_Kosovo\\_Status\\_Report\\_2018.pdf](https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Municipal_Waste_Managment_in_Kosovo_Status_Report_2018.pdf) page 25

Ekzistenca e këtyre deponive përbën shkelje të të drejtave të njeriut, duke krijuar ndotje të ambientit dhe duke rrezikuar shëndetin e qytetarëve të Kosovës. Për më tepër, kushtet në deponitë si 'Mirash' afër Prishtinës paraqesin një katastrofë të mundshme mjedisore të ngjashme me aksidentin e Dumpit të Hapur Umraniye-Hekimbasi I cili ka ndodhur në vitin 1993 në Stamboll, ku mbetën të vrarë 39 njerëz.<sup>4</sup>

Kosova në legjisllacionin e saj, gjithashtu përmban disa direktiva të Bashkimit Evropian lidhur me menaxhimin e mbeturinave. Norma e harmonizimit të këtyre direktivave tregohet në tabelën e mëposhtme.<sup>5</sup>

*Norma e Harmonizimit të Direktivave të BE-së në Kosovë*

Direktiva	Norma e Harmonizimit
Direktiva e mbeturinave (2006/12/EC)	95%
Direktiva mbi Mbeturinat e Rrezikshme(91/689/EC)	100%
Direktiva për Paketat e Mbeturinave	88%
Direktiva për deponitë	69%

Edhe pse korniza ligjore e Kosovës për menaxhimin e mbeturinave përgjithësisht është në përputhje me direktivat e BE-së, probleme të shumta ka kur është fjala për zbatimin e kësaj kornize dhe iakteve tjera ligjore sepse Kosova ende nuk është në gjendje të përmbushë standardet mjedisore të përcaktuara nga legjisllacioni në fuqi. Për të adresuar dhe tejkaluar këto sfida, duhet të miratohen masa për të përmirësuar kuadrin legjisllativ në fushën e mjedisit, duhet të zhvillohen politika në përputhje me standardet Evropiane dhe duhet përmirësuar kapaciteti institucional i Qeverisë në nivel qendror dhe lokal për zbatimin e legjisllacionit në fuqi.

### 2.1.2 Strategjia qëndrore dhe plani për menaxhimin e mbeturinave

Strategjia e Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave (SKMM) dhe Plani i Kosovës për Menaxhimin Mbeturinave janë në kuadër të MMPH. SKMM përcakton vizionin e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë. Objektivi kryesor i Strategjisë është krijimi i një kornize masash brenda së cilës në Kosovë do të zvogëlohej sasia e mbeturinave që aktualisht krijohet dhe krijimin e sistemit të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave. Fokusi kryesorë është:

- Zvogëlimin e krijimit të sasisë së mbeturinave në burim si dhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që duhet të deponohen;
- Zhvillimin e infrastrukturës për ngritjen e sistemit të integruar në menaxhimin

<sup>4</sup> BIRN paralajmëron për rreziqet e deponive në Kosovë: <https://balkaninsight.com/2018/05/25/mirash-landfill-an-environmental-catastrophe-in-kosovo-05-25-2018/>

<sup>5</sup> Veprimete Bashkimit Evropian për të luftuar Krimin Mjedisor, Promovimi i BE-së për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë: [https://efface.eu/sites/default/files/EFFACE\\_The%20EU%20promotion%20of%20environmental%20protection%20in%20Kosovo\\_revised.pdf](https://efface.eu/sites/default/files/EFFACE_The%20EU%20promotion%20of%20environmental%20protection%20in%20Kosovo_revised.pdf)

e mbeturinave (Zvogëlim – Ripërdorim - Riciklim- Djegje - Deponim) pra duke krijuar kushtet për një funksionim efektiv të sistemit;

- Zvogëlimin e rrezikut nga mbeturinat;
- Kontributin për rritjen e punësimit në vend;
- Ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave;
- Përmirësimi i shërbimit të mbeturinave;
- Edukimi i publikut, trajnimi i zyrtarëve;
- Kompletimi i legjislacionit dhe udhëzuesve për mbeturinat.<sup>6</sup>

SKMM është e aplikueshme për periudhën dhjetë (10) vjeçare, nga viti 2013 – 2022; ku rishikimi pesë (5) vjeçarë i parëdhë analizimi i ndikimit të zbatimit të kësaj Strategjie është planifikuar të përfundojë së shpejti. Njëjtë sikurse SKMM, Plani i ri për Menaxhimin e Mbeturinave në Kosovë për zbatimin e SKMM është në përfundim. Qëllimi i PMMK është krijimi i një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë në përputhje me standardet Evropiane. Një prej qëllimeve të SKMM është edhe krijimi i vendeve të reja të punës për qytetarët e Kosovës.

### 2.1.3 Kompetencat Komunale në menaxhimin e mbeturinave

Ligji për Mbeturinat, Neni 15, shpjegon detyrat e komunave në lidhje me menaxhimin e mbeturinave të cilat janë:

- Hartimi i planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave;
- Të hartoj raportin vjetor për menaxhimin e mbeturinave i cili duhet dorëzuar në Ministri deri më 31 mars të vitit vijues;
- Rregullimi i përgjegjësive dhe detyrimeve për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, zbatimi i tyre organizimin dhe menaxhimin e mbeturinave në territorin e tyre;
- Mirëmbajtja dhe përkujdesja për sistemin e informimit të publikut dhe raportimit për kryerjen e punëve të përcaktuara me këtë ligj, si dhe aktet tjera ligjore për menaxhimin e mbeturinave;
- Duke zbatuar procedurat e prokurimit, përzgjedh personat e licencuar për mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe transportin e mbeturinave: inerte, komunale, komerciale, të vëllimshme, dhe mbeturinat nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore brenda territorit të tyre;
- Komuna cakton tarifat dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare për shërbimet komunale;
- Evidentimi i vendeve të ndotura në territorin e tyre, hartimi i projekteve për sanimin e tyre me shënime për lokacionin, karakteristikat hapësinore gjeometrike, lloji i ndotjes, sasia e mbeturinave, afatet për përmirësimin e gjendjes dhe shënime të tjera me rëndësi për realizimin e projekteve.<sup>7</sup>

<sup>6</sup> Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Strategjia e Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2022, [https://mmp.hks-gov.net/repository/docs/Strategy\\_of\\_Republic\\_Kosova\\_for\\_WM\\_2013-2022\\_eng\\_945753.pdf](https://mmp.hks-gov.net/repository/docs/Strategy_of_Republic_Kosova_for_WM_2013-2022_eng_945753.pdf)

<sup>7</sup> Ligji për mbeturinat Nr.04/L-060

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, 24 komuna janë përgjegjëse për zhvillimin ekonomik lokal, mbrotjen e mjedisit lokal, dhe menaxhim të mbeturinave (këto përgjegjësi janë pjesë e shërbimeve komunale).<sup>8</sup> Për më tepër, komunat mund të nxjerrin ligje dhe akte nën-ligjore të cilat kanë për qëllim të rregullojnë funksionimin e komunës përkatëse dhe të arrijnë standardetë larta në ofrimin e shërbimeve për qytetarët, duke e përfshirë edhe menaxhimin e mbeturinave.

#### **2.1.4 Institucionet tjera publike që merren me menaxhimin e mbeturinave**

##### *Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM)*

ZRRUM është rregullator i pavarur ekonomik për ujë dhe shërbime të mbeturinave të ngurta në Kosovë. Roli i kësaj zyre është të ofroj shërbime me çmime të arsyeshme për konsumatorë, gjithmonë duke mbrojtur mjedisin dhe shëndetin publik.

##### *Ndërmarrjet Publike (NP)*

Disa kompani rajonale të mbeturinave të definuara si ndërmarrje publike mbledhin, transportojnë, dhe hudhin mbeturina në një apo më shumë komuna. Këto kompani rajonale janë: "Pastrimi" në Prishtinë, "Ekoregjioni" në Prizren, "Ambienti" në Pejë, "Uniteti" në Mitrovicë, "Çabрати" në Gjakovë, "EcoHigjiena" në Gjiilan and "Pastërtia" në Ferizaj.

##### *Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore (AKMRRSB)*

Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe për Siguri Bërthamore është agjenci ekzekutive e cila vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës. Kjo Agjenci funksionon e ndarë nga çfarëdo trupi ose organizate tjetër e cila merret me promovimin ose përdorimin e praktikave të rrezatimit ose përdorimin e energjisë bërthamore. Një prej detyrave të Agjencisë është miratimi i kornizës ligjore e cila ka të bëjë me mbrojtjen nga rrezatimi dhe sigurinë bërthamore, licencimi dhe inspektimi, dhe krijimi i sigurisë dhe ofrimi i një mjedisi të shëndetshëm për të gjithë qytetarët.

##### *Bordi Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit (BKMM)*

Bordi, i themeluar nga Kuvendi i Kosovës, ofron këshilla Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës për çështjet e mjedisit. Shtatë (7) anëtarë të këtij Bordi janë ekspertë të mjedisit dhe shkencëtarë të emëruar nga Kuvendi.

<sup>8</sup> Ligji për vetë-qeverisjen lokale, Nr. 03/L-040, Neni 17.

## 2.2 Reciklimi

Shëndeti mjedisor i Kosovës është konsideruar si ‘shumë i keq’ dhe raporti i vitit 2018 mbi Menaxhimin e Mbeturinave Komunale në Kosovë i publikuar nga Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit e konsideron sistemin aktual të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në Kosovë si ‘ekologjikisht të paqëndrueshëm’.<sup>9</sup> Ndarja e mbeturinave ekziston vetëm në disa komuna dhe mbledhja e mbeturinave të riciklueshme është krejtësisht e varur nga sektori joformal.

Përderisa ka tregues të qartë se Qeveria e Kosovës është e vetëdijshme për përfitimet mjedisore dhe ekonomike që mund të sjellë zhvillimi i sektorit të riciklimit, deri tani investimet nga nivelin qendror janë planifikuar por nuk zbatohen.

Siç u cek më lart, sektori joformal është organi më aktiv në mbledhjen dhe klasifikimin e mbeturinave të cilat pastaj u shiten bizneseve (~70 të licencuara) të cilët pastaj i përpunojnë dhe eksportojnë. Disa lloje të mbeturinave të grumbulluara nga bizneset (kompostimi i mbetjeve organike, ripërdorimi i gomave, ripërdorimi dhe ruajtja e naftës dhe produkteve të benzinës etj.) përdoren apo riciklohen nga bizneset vet. Sipas të dhënave të dalta në vitin 2016 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), 53,218-ton e mbeturinave janë përpunuar nga bizneset private dhe 10,674 ton janë eksportuar tek kompanitë e riciklimit në shtete të ndryshme. 62,461 ton janë mbledhur nga kompanitë, që përbëjnë 15% të sasisë totale të mbeturinave të grumbulluara (rreth 416,379 ton mbeturina janë mbledhur në 2017); rrjedhimisht, sasia e mbeturinave që eksportohet në krahasim me sasinë totale të mbeturinave të grumbulluara është vetëm 2.6%.<sup>10</sup>

### *Sasitë e mbeturinave të riciklueshme të përpunuara nga kompanitë në Kosovë*

Lloji i mbeturinave	Sasia e materialit të marrë (Ton)	Sasia e materialit të prodhuar (Ton)	Sasia e materialit të përpunuar (Ton)	Sasia e materialit të eksportuar (Ton)
Metal	41,756	33,207	40,232	4,046
Plastik	10,163	12,091	11,686	498
Letër	5,322	5,312	3,860	6,128
Tjera	5,220	5,220	5,220	199
Total	62,461	55,830	60,998	10,871

<sup>9</sup> Agjensioni I Kosovës për mbrojtje nga mjedisi, Raporti Komunal për menaxhimin e mbeturinave, 2018, [https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Municipal\\_Waste\\_Management\\_in\\_Kosovo\\_Status\\_Report\\_2018.pdf](https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Municipal_Waste_Management_in_Kosovo_Status_Report_2018.pdf)

<sup>10</sup> Ibid.

## 2.3 Vështirësitë në menaxhimin formal të mbeturinave dhe roli i mbledhësve joformalë të mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave është një industri komplekse në Kosovë, e cila përfshinë një sërë akterësh publikë dhe privatë në nivel komunal dhe qendrorë. Mbeturinat përgjithësisht grumbullohen në pikat e përcaktuara nga kompanitë rajonale të mbeturinave dhe hedhen në deponi.

Kompanitë rajonale publike mbledhin mbeturina nga pikat e grumbullimit të caktuar në zonat urbane dhe rurale, dhe pastaj i transportojnë në deponitë e caktuara të cilat menaxhohen nganjë ndërmarrje tjetër publike e cila është Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë. Gjithashtu ekzistojnë deponitë ilegale në tërë Kosovën të cilat përbëjnë rrezik shëndetësor për qytetarët dhe mjedisin.

Kompanitë private të angazhuara për grumbullimin, menaxhimin dhe përpunimin e mbeturinave blejnë mbeturina të paklasifikuara të papërpunuara dhe sendet e tjera të vlefshme nga më shumë se një burim. Këto kompani blejnë mbeturina nga supermarket, ndërmarrjet private dhe publike, si dhe grumbulluesit joformal të mbeturinave. Shumica e këtyre kompanive licencohen nga MMPH për të kryer shërbime të ndryshme si ato të grumbullimit, transportit, magazinimit, menaxhimit dhe përpunimit të mbeturinave. Pjesa më e madhe e mbeturinave të grumbulluara dhe të përpunuara nga kompanitë shiten jashtë vendit.

Akterë kryesor dhe shumë të rëndësishëm janë grumbulluesit joformal të mbeturinave të cilët në të shumtën e rasteve i përkasin komuniteteve me problem socio-ekonomike. Grumbulluesit individual joformal të mbeturinave shihen si urë lidhëse në mes të kompanive formale dhe joformale të grumbullimit të mbeturinave. Grumbulluesit joformal të mbeturinave janë persona të cilët jetojnë në varfëri të skajshmenë Kosovë. Këta persona janë pjesëtarë të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian; por jo vetëm. Për shembull, në rajonin e Pejës dhe Gjakovës, shumë të varfër nga komuniteti shumicë janë grumbullues joformal të mbeturinave.



### **3. KUSHTET E PUNËS DHE TË DREJTAT THEMELORE TË MBLEDHËSVE JOFORMAL TË MBETURINAVE**

#### **3.1 Situata e grumbulluesve joformal të mbeturinave**

Grumbulluesit joformalë të mbeturinave në Kosovë kërkojnë mbeturina në kontejnerë publik, të cilat janë pronë dhe administrohen nga kompanitë rajonale të mbeturinave në komunat përkatëse, i klasifikojnë ato dhe më pas i u shesin kompanive private të cilat mirren me mbledhjen dhe menaxhimin e mbeturinave. Përveç grumbullimit të mbeturinave nga kontejnerët publik, ata gjithashtu mundohen të gjejnë burime të tjera për mbledhjen e mbeturinave, burime të cilat janë joformale dhe të paligjshme. Grumbulluesit joformalë të mbeturinave në përgjithësi nuk janë të organizuar, nuk janë pjesë e ndonjë strukture formale, nuk kanë marrëveshje zyrtare me kompanitë private, dhe vijnë nga pjesa më e cënueshme dhe e marginalizuar e shoqërisë Kosovare. Grumbulluesit joformalë të mbeturinave nuk janë të licencuar nga MMPH ose ndonjë autoritet tjetër përkatës, siç kërkohet me Ligjin për Mbeturinën, për arsye se shumica e grumbulluesve joformal të mbeturinave nuk kanë njohuri të mjaftueshme për kërkesat ligjore për të u licencuar si dhe kanë frikë që mund të humbasin shtesat dhe shërbimet sociale që marrin nga shteti i Kosovës.

Diku rreth 1/3 e qytetarëve që jetojnë në Kosovë kanë kushtë të vështira socio-ekonomike, duke jetuar me më pak se një euro dhe 72 centë në ditë, e dhënë kjo e marrë nga statistikat Qeverisë të publikuara në vitin 2016. Siç u tha, një pjesë e madhe e mbledhësve joformal të mbeturinave i përkasin komuniteteve me kushte më të vështira ekonomike dhe që janë në pozitë më të cënueshme siç janë komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Për arsye që këto komunitete ende ballafaqohen me diskriminim etnik, janë të papunë dhe kanë sigurim të kufizuar social, detyrohen të gjejnë zgjedhje të mbijetojnë, rrjedhimisht të veprojnë si mbledhës joformal të mbeturinave<sup>11</sup> ku angazhimin në këtë sektor e shohin si burim të vetëm të të ardhurave.

Grumbulluesit joformal të mbeturinave në Kosovë punojnë në kushte të jashtëzakonshme dhe të pakëndshme, dhe marrin një kompenzim jashtëzakonisht të vogël për punën të cilën e bëjnë. Kjo në parim, është shkelje e të drejtave të njeriut, duke u bazuar në ligjet e Kosovë dhe ligjet ndërkombëtare. Nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës, tetë (2) Instrumente Ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë të aplikueshme në Kosovë.<sup>12</sup> Sipas Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), duke u bërë pjesë e këtyre instrumenteve, Shteti merr për obligim të i respektojë, mbrojë dhe përmbushë të gjitha të drejtat e cekura në këto instrumente.

<sup>11</sup> Gjuetarët e mbeturinave: grumbulluesit e shfrytëzuar të skrapit në Kosovë: <https://balkaninsight.com/2019/02/11/scavenger-hunters-kosovos-exploited-scrap-collectors/>

<sup>12</sup> Kushtetuta e Kosovës: [http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se\\_.Kosoves-2.pdf](http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se_.Kosoves-2.pdf)

Obligim të respektohen të drejtat e njeriut do të thotë që Shteti duhet të sigurojë që të gjithë qytetarë të i gëzojnë të drejtat e tyre themelore. Obligim të i mbrojë do të thotë që Shteti duhet të i mbrojë individët dhe grupet që ballafaqohen me shkelje të të drejtave të tyre. Obligim të i përmbushë do të thotë që Shteti duhet të ndër marrë veprime positive të cilat u garantojnë të gjithë qytetarëve gëzim të të drejtave të tyre themelore.

Si obligim shtetërorë të i mbrojë dhe veçanërisht përmbushëdetyrimet e përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligje, Kosovaduhet të punojë në krijimin e reformave të reja për menaxhimin e mbeturinave, të cilat do të kontribuojnë për të i përmirësuar kushtet për grumbulluesit joformal të mbeturinave dhe të sigurojë që të drejtat themelore të njeriut të respektohen.

Në pjesën e mëposhtme të këtij raporti përshkruhen vështirësitë me të cilat ballafaqohengrumbulluesit joformal të mbeturinave në sistemin aktual.

### 3.2 Problemet shëndetësore dhe siguria në punë

Grumbulluesit joformal të mbeturinave punojnë në kushte të papërshtatshme jo-higjienike që shkaktojnë dëme të mëdha shëndetësore. Kjo ndodhë për faktin që grumbulluesit joformal të mbeturinave kërkojnë materiale të riciklueshme dhe lëndë të para në plehra dhe mbeturina industriale të cilat më pas i shesin tek qendrat e ndryshme të riciklimit. Marrëveshjet ndërmjet grumbulluesve joformal të mbeturinave dhe grumbulluesve të mbeturinave janë të rralla. Për këtë arsye, grumbulluesit joformal të mbeturinave mbesin në pozicion mjaft të ndjeshëm pasi që ata jo gjithmonë marrin në këmbim çmimin e merituar pas shitjes së materialeve të cilat ata i ofrojnë. Për më tepër, duke punuar vetëm në mënyrë individuale, ata nuk kanë mundësi të përmirësojnë kushtet e tyre të punës apo të ngrisin çështje të caktuara me kompanitë që i shfrytëzojnë shërbimet e tyre.

Shumë prej tyre punojnë në kushte mjaft të vështira pa paisje dhe mjete adekuate të sigurisë dhe i ekspozohen materialeve të rrezikshme, ku si pasojë rrezikohen të preken nga sëmundje të ndryshme siç janë tifoid, salmonella, gastroenterit ose kolera.<sup>13</sup>


Është e natyrshme dhe e drejtë themelore që secilit individ duhet të ijepet mundësia për të punuar në një mjedis të sigurt me mjete dhe pajisje të përshtatshme, tëketë mundësi të bëjë një punë më efektive dhe e cila nuk shkakton pasoja shëndetësore. Për fat të keq, individët që punojnë si grumbullues joformal të mbeturinave në Kosovë nuk i gëzojnë këto kushte dhe të drejta.

<sup>13</sup>Gjuetarët e mbeturinave: grumbulluesit e shfrytëzuar të skrapit në Kosovë: <https://balkaninsight.com/2019/02/11/scavenger-hunters-kosovos-exploited-scrap-collectors/>

Për më tepër, edhe pse grumbulluesit joformal të mbeturinave luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në sistemin e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë, ata nuk marrin lehtësim në licensim, nuk kanë siguri në punë, dhe nuk përfitojnë nga ndonjë iniciativë shtetërore paisje, mjete apo veshje të sigurisë. Grumbulluesit joformal të mbeturinave nuk posedojnë njohuritë e nevojshme në lidhje me procedurat sanitare dhe të sigurisë që ata duhet ndjekur në momentin që punojnë me material jo-highienike dhe të rrezikshme në mënyrë që të mos shkaktojnë dëme shëndetësore. Rrjedhimisht, shumë aksidente ndodhin çdo vit me pasoja të mëdha të cilat shpesh shkaktojnë edhe vdekjen.<sup>14</sup>

### 3.3 Mungesa e paisjeve

Mungesa më e madhe me të cilën përballen grumbulluesit joformal të mbeturinave është mjetet e pamjaftueshme të transportit e cila gjithashtu cilësohet si pengesë dhe ndikon në zvogëlimin e gjenerimit të të ardhurave. Kostoja e transportit dhe kohëzgjatja e procesit të transportimit të mbeturinave të grumbulluara nga kontenjerët tek deponitë dhe më pas tek kompanitë private për shitje është njëproblematikë mjaft e madhe për grumbulluesit joformal të mbeturinave. Në sondazhet e publikuara nga ECMI Kosova në vitin 2015, shumica dërrmuese e grumbulluesve joformal të mbeturinave që janë anketuar kanë treguar që nuk përdorin automjete të motorizuara për industrinë e tyre por përdorin karroca, biçikleta apo edhe thasë të mëdha të cilë pastaj i bartin në këmbë.<sup>15</sup>



*Paisjet e përdorura për mbledhjen e mbeturinave nga të anketuarit*

<sup>14</sup>. Ibid.

<sup>15</sup>. Sondazhi i publikuar nga ECMI Kosova, 2015: [http://www.ecmikosovo.org/uploads/Recycle%20\\_ENG\\_preview.pdf](http://www.ecmikosovo.org/uploads/Recycle%20_ENG_preview.pdf)

Disa grumbullues të mbeturinave marrin kamion privat për transportimin e mbeturinave të mbledhura nga magazina e tyre (zakonisht oborri i shtëpisë së tyre shfrytëzohet si magazinë) tek kompanitë private. Ky shërbim megjithatë u kushton grumbulluesve joformal të mbeturinave duke i u zvogëluar të ardhurat e krijuara gjatë gjithë javës deri në 50%. Gjithashtu kufizon ata për të i shitur dhe dërguar mbeturinat tek kompanitë private në momentin e mbledhjes së tyre pasi ata duhet të mundohen të gjejnë mjete transportuese me të cilin i bartin mbeturina e mbledhura gjatë tërë javës.

Si pjesë të këtij hulumtimi, ne kërkuam nga grumbulluesit joformal të mbeturinave të i përmendin nevojat e tyre të cilat ata i shohin si më të domosdoshme në mbledhjen e mbeturinave të cilat do të ju përmirësonin punën e përditshme të tyre si grumbullues joformal dhe shumica prej tyre (më shumë se 80%) kanë përmendur sigurimin e transportit. Grumbulluesit joformal të mbeturinave kanë përmendur specifikisht multi-kultivatorët si mjet i tyre i preferuar për bartjen e mbeturinave; megjithatë, shumica prej tyre përdorin karrocë dore ose thesë. Mjetet tjera praktike që mund të përdoren për bartjen e mbeturinave përmirësojnë jetën e grumbulluesve duke: a) zvogëluar koston; b) zvogëluar kohën dhe mundin që duhet të bëhet për të i bartur mbeturina nga pika A tek pika B; c) lehtësuar mbledhjen e mbeturinave; mundësuar grumbulluesvetë deponojnë sasi më të mëdha njëherish; dhe d) mundësuar bartjen e mbeturinave tek pikat e caktuara ne po atë ditë të grumbullimit, më shumë se një herë në ditë.

### 3.4 Të ardhura të vogla

Gjenerimi i vogël i të ardhurave financiare nga grumbulluesit joformal të mbeturinave në Kosovë është paraqitur në raportin e publikuar nga ECMI Kosova në vitin 2015. Nga anketat e zhvilluara me individë të që punojnë si grumbullues joformal të mbeturinave, është gjetur si rezultat që një shumicë e madhe e tyre nuk fitojnë më shumë se 100 Euro në muaj dhe një numër i konsiderueshëm i tyre fiton më pak se 50 Euro në muaj.

Të ardhurat mesatare mujore	% e grumbulluesve joformal të mbeturinave të anketuar
<50€	21%
50€-100€	67%
>100€	12%

*Të ardhurat mujore mesatare të të anketuarve<sup>16</sup>*


<sup>16</sup> Ibid.

Shqetësimet për të ardhurat e vogla të grumbulluesve joformal të mbeturinave rriten kur marrim parasysh që këto fitime përdoren për të siguruar ushqim për anëtarë të familjes. Në tabelë më poshtë mund të shihet numri i anëtarëve të familjeve të të anketuarve që përfitojnë nga të ardhurat e siguruar nga mbledhja e mbeturinave.<sup>17</sup>

# i anëtarëve të familjes që përfitojnë nga të ardhurat e siguruar nga mbledhja e mbeturinave	% e grumbulluesve joformal të mbeturinave të anketuar
1-3	12%
4-6	39%
7-9	33%
10+	10%

Të ardhura tjera financiare të të anketuarve ishin të vogla Shumica prej tyre nuk kishin burim tjetër të të ardhurave kurse disa prej tyre deklaruan që marrin ndihmë sociale nga shteti i Kosovës. Sistemi i ndihmës sociale që ipet nga shteti i Kosovës për grupet qëi përmbushin kushtet e caktuara, është kritikuar dhe cilësohet si i pamjaftueshëm.<sup>18</sup> Fakti që grumbulluesit joformal të mbeturinave varen vetëm nga të ardhurat që ata nxjerrin nga mbledhja dhe shitja e mbeturinave (të ardhurat mesatare mujore të paraqitura më lartë) apo nga ndihma sociale e pamjaftueshme që ofrohet nga shteti i Kosovës e cila është 59 cent për ditë për person,<sup>19</sup> duhet të konsiderohet si tregues i rëndësishëm i gjendjes së keqe aktuale në Kosovë pasi që shumica e fituar dhe e caktuar nga shteti nuk mbulon as shpenzimet minimale të individit.<sup>20</sup>

*Burim tjera të të ardhurave të të anketuarve*<sup>21</sup>



<sup>17</sup>. Ibid.

<sup>18</sup>. Fondi Monetar Ndërkombëtar, Departamenti i Çështjeve Fiskale në Kosovë, Përmirësimi i Përfitimeve të Parave në Mbrojtje Sociale, mars 2016 <https://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2016/cr16123.pdf>

<sup>19</sup>. Strategjia për përfshirjen e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, faqe 22

<sup>20</sup>. Varfëria e konsumit në Kosovë: <http://ask.rks-gov.net/media/3187/poverty-report-2012-2015.pdf>

<sup>21</sup>. Sondazhi i publikuar nga ECMI Kosova, 2015: [http://www.ecmikosovo.org/uploads/Recycle%20\\_ENG\\_preview.pdf](http://www.ecmikosovo.org/uploads/Recycle%20_ENG_preview.pdf)

Arsyeja kryesore e gjenerimit të të ardhurave të vogla nga grumbulluesit joformal të mbeturinave është mungesa e koordinimit dhe organizimit të mjaftueshëm në nivel më të lartë. Mund të thuhet që krijimi i një mekanizmi i cili do të përmirësojë koordinimin dhe organizimin e grumbullimit të mbeturinave mund të shpien tek sigurimi i të ardhurave më të qëndrueshme dhe të sigurta: nga 88 të anketuar të cilë janë pyetur se nëse kanë nënshkruar ndonjë marrëveshje me ndonjë kompani për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave, vetëm një (1) është përgjigjur pozitivisht.

### 3.5 Punësimi i fëmijëve

Një tjetër shqetësim i madh në industrinë e grumbullimit joformal të mbeturinave është punësimi i fëmijëve. Sipas Ligjit të Punës, marrëdhënia e punës mund të themelohet me personat në mes të moshës pesëmbëdhjetë (15) deri në tetëmbëdhjetë (18) vjeç, të cilët mund të punësohen për punë të lehta që nuk paraqesin rrezik për shëndetin ose zhvillimin e tyre dhe nëse ajo punë nuk është e ndaluar me ndonjë ligj ose akt nënligjor.<sup>22</sup> Për më tepër, edhe pse Kosova nuk është anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), dhe nuk është palë nënshkruese e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve (KNMDF), siç e cekur më lartë në këtë raport, Kushtetuta e Kosovës në Nenin 22 të saj, e ka të përfshirë edhe këtë konventë në listen e tetë (8) Instrumenteve Ndërkombëtare të cilat aplikohen në Kosovë. Neni 32 i kësaj konvente thotë “shtetet palë njohin të drejtën e fëmijës për të u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rreziqe ose që cënon edukimin e tij/saj ose dëmton shëndetin apo zhvillimin e tij/saj fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror”.<sup>23</sup>

Nga ana tjetër, të dhënat gjithashtu tregojnë që statusit socio-ekonomik që shpie tek angazhimi i fëmijëve në tregun e punës, ka ndikim tek vijueshmëria e tyre në shkollë; kështu që, mund të thuhet që fëmijët që i përkasin familjeve me kushte më të vështira socio-ekonomike kanë predispozita më të mëdha të kyçen në tregun e punës për të i mbështetur financiarisht familjet e tyre dhe të e braktisin shkollimin. Sipas Raportit të Vlerësimit për Zbatimin e Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë kosovare në vitin 2017, në arsimin e mesëm të lartë më pak se një e treta (30%) e fëmijëve të moshës përkatëse vijnë në shkollën e mesme të lartë, ndërsa shumica (60%) janë plotësisht jashtë shkollës.<sup>24</sup>

<sup>22</sup> Ligji i Punës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2735>

<sup>23</sup> Konventa për të drejtat e fëmijës <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AConRightsChild.pdf>

<sup>24</sup> Raporti i vlerësimit të zbatimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shoqërinë kosovare, 2017; <http://kosint2020.net/sq/lajme-dhe-ngjarje/raporti-i-vleresimit-te-zbatimit-te-strategjise-per-perfshirjen-e-komuniteteve-rom-dhe-ashkali-ne-shoqerine-kosovare-ne-vitin/>; Raport Tematik, Zbatimi i Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës, 2018.

Angazhimi i fëmijëve të cënueshëm në tregun e punës, kryesisht është në sektorin e mbledhjes së mbeturinave. Fëmijët e angazhuar ose punojnë individualisht ose së bashku me familjarët e tjerë.<sup>25</sup> Në fakt, një sondazhibërë nga UNICEF në mes të viteve 2013 dhe 2014 tregon që nga 5,398 fëmijë në Kosovë të angazhuar në tregun e punës, 2,168 prej tyre ishin nga komunitetet Rom, Ashkali apo Egjiptian.<sup>26</sup> Një studim tjetër i publikuar nga UNICEF, ka gjetur që 87% e fëmijëve që janë të përfshirë në tregun e punës dhe në të njejtën kohë ndjekim edhe shkollimin jetojnë në qytete, kurse 13% të fëmijëve që punojnë e jetojnë në vendet rurale nuk kanë mundësi të e ndjekin shkollimin për arsye që shkollat nuk e kanë sistemin e ndërrimeve të orarit mësimorë. Shumica e këtyre fëmijëve punojnë si grumbullues joformal të mbeturinave.<sup>27</sup> Më së shumti nga ky fenomen preken djemtë të moshës 14 deri 18 vjeç të cilët cilësohen që kanë aftësi fizike për të e kryer këtë punë, të cilët gjithashtu nuk e shohin shkollimin si rrugë e cila kontribon në rritjen e mundësive për të gjetur një punë më të mirë në të ardhmen.<sup>28</sup>

Përveç aspektit të arsimit, pasojë tjetër mjaft e rëndë që mund të kenë fëmijët e angazhuar në sektorin e grumbullimit të mbeturinave janë problemet shëndetësore dhe rreziku që ata e marrin i cili mund të ju kushtojë me jetë. Duke u ndërlidhur me këtë shqetësim, duhet të përmendim që në vitin 2014, një fëmijë është ngacmuar nga qentë e rrugës afër deponive të mbeturinave i cili ka gjetur edhe vdekjen.<sup>29</sup>

Nga përvoja e viteve të kaluara të ECMI Kosovës në këtë sektor, mund të themi që një numër i madhë i individëve që punojnë në sektorin e grumbullimit të mbeturinave kërkojnë ndihmë nga familjarët e tyre, nën moshë, të i mbështesin në punën e përditshme të tyre.

---

<sup>25</sup> Punësimi I fëmijëve dhe punësimi I detyruar në Kosovë: [https://www.dol.gov/sites/dolgov/files/ILAB/child\\_labor\\_reports/tda2017/Kosovo.pdf](https://www.dol.gov/sites/dolgov/files/ILAB/child_labor_reports/tda2017/Kosovo.pdf)

<sup>26</sup> UNICEF, Monitorimi i situatës së fëmijëve dhe grave 2013-2014: [https://mics-surveys-prod.s3.amazonaws.com/MICS5/Central%20and%20Eastern%20Europe%20and%20the%20Commonwealth%20of%20Independent%20States/Kosovo%20under%20UNSC%20res.%201244/2013-2014/Final/Kosovo%20%28UNSCR%201244%29%202013-14%20MICS\\_English.pdf](https://mics-surveys-prod.s3.amazonaws.com/MICS5/Central%20and%20Eastern%20Europe%20and%20the%20Commonwealth%20of%20Independent%20States/Kosovo%20under%20UNSC%20res.%201244/2013-2014/Final/Kosovo%20%28UNSCR%201244%29%202013-14%20MICS_English.pdf); UNICEF, Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë: Anketa e Grupeve me Treguesve të shumëfishtë 2013-2014. Prishtinë; 2014 <https://mics-surveys-prod.s3.amazonaws.com/MICS5/Central%20and%20Eastern%20Europe%20and%20the%20Commonwealth%20of%20Independent%20States/Kosovo%20under%20UNSC%20res.%201244%20%28Roma%2C%20Ashkali%2C%20and%20Egyptian%20Communities%29/2013-2014/Final/Kosovo%20>

<sup>27</sup> UNICEF, Punësimi I fëmijëve në Kosovë: Studim për fëmijët e punësuar: [https://www.unicef.org/kosovo-programme/kosovo\\_media\\_pub\\_prot.008.04.pdf](https://www.unicef.org/kosovo-programme/kosovo_media_pub_prot.008.04.pdf)

<sup>28</sup> Ibid.

<sup>29</sup> Gazeta Express Artikull: Qentë mbysin 5-vjeçarin në Fushë Kosovë – banorët rrëfejnë për tmerrin <https://www.gazetaexpress.com/lajme/qente-mbysin-5-vjecarin-ne-fushe-kosove-banoret-rrefejne-per-tmerrin-foto-67335/?archive=1>

Duke e marrë marasysht këtë fakt, ECMI Kosova në kuadër të projekteve të ndryshme, ka marrë disa hapa për të adresuar këtë çështje të cilët janë: a) informojë dhe trajnojë personat e angazhuar në sektorin e grumbullimit joformal të mbeturinave që angazhimi i fëmijëve është e jashligjshme dhe ndikon negativisht në zhvillimin psikologjik dhe mendor të fëmijëve; b) informojë personat e angazhuar në sektorin e grumbullimit joformal të mbeturinave që angazhimi i fëmijëve në këtë sektor ndikon në zvogëlimin e mundësive të tyre për të u fokusuarë mësim dhe krijon hapësirë për braktisje të shkollimit; c) angazhimi i fëmijëve në sektorin e grumbullimit joformal të mbeturinave është i dëmshëm për shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve.

Edhe pse Ligji i Punës ndalon punën e fëmijëve nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare për punë të përgjithshme dhe nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare për punë e cila i shpie në kontakt me material të rrezikshme, një studim i publikuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP) ka gjetur që fëmijët edhe më të rinj se dhjetë (10) vjeç janë të angazhuar në tregun e punës, shpesh të bëjnë punë që nuk janë të sigurt dhe të kenë kontakt me materiale të cilat janë të rrezikshme për shëndetin e tyre.<sup>30</sup>

Numri i anëtarëve të familjes që punojnë si grumbullues të mbeturinave	% e numrit total të grumbulluesve të mbeturinave
1	33%
2	25%
3	9%
4 ose më shumë	4%

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka marrë disa hapa për të zvogëluar dhe zhdukur punësimin e fëmijëve sidomos në ato punë që përbëjnë rrezik, specifikisht, në sektorin e grumbullimit të mbeturinave. MPMS, e mbështetur nga ONP, ka nxjerrur një Udhëzim Administrativ 05/2013 Për parandalimin dhe zhdukjen e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë. Gjithashtu, ka hartuar Planin e Veprimit për parandalimin dhe zhdukjen e formave të rrezikshmetë punës së fëmijëve në Kosovë i cili ka për qëllim të gjejë “zgjidhje të shpejta” për të adresuar problemin e punësimit të fëmijëve. Nisma të ngjashme është parë të jenë marrë edhe nga Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), e cila ka kërkuar nga anëtarët e saj (kompanitë) të miratojnë kod të sjelles dhe rregullore të cilat kontribuojnë “në luftën kundër punësimit të fëmijëve”, ku sipas raportit të publikuar nga ONP, deri më tani vetëm 40 kompani e kanë bërë këtë.<sup>31</sup>

<sup>30</sup>. ONP: Ndalimi i punës së fëmijëve në Kosovë: Le të jenë fëmijët fëmijë. Shkurt 9, 2015: [http://www.ilo.org/global/about-the-ilo/newsroom/features/WCMS\\_343157/lang--en/index.htm](http://www.ilo.org/global/about-the-ilo/newsroom/features/WCMS_343157/lang--en/index.htm).

<sup>31</sup>. Kombet e Bashkuara, Lufta kundër Punës së Fëmijëve duke fituar momentin në Kosovë, thotë Agjencia e OKB, 2015 <https://news.un.org/en/story/2015/02/490572>



#### **4. KONTRIBUTI I SHOQËRISË CIVILE NË ADRESIMIN EÇËSHTJESSË GRUMBULLIMIT JOFORMAL TË MBETURINAVE**

Duke marrë parasysh nevojat e pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ECMI Kosova ka zbatuar projektin “Rritja e punësimit të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian përmes reciklimit kolektiv”, i cili ka qenë i financuar nga Bashkimi Evropian dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe është zbatuar nga dhjetori I vitit 2014 deri në dhjetor të vitit 2016. Ky projekt është zbatuar në bashkëpunim me organizatën Help for All dhe Roma and Ashkalia Documentation Centre (RADC). ECMI Kosova në bashkëpunim me partnerët e saj për dy (2) vite ka organizuar një sërë aktivitete të cilat janë: vizita në terren; intervista direkte me komunitete; organizim të sesioneve informuese me qëllim të identifikimit, mbledhjes dhe klasifikimit të mbeturinave; dhe sesione të trajnimeve të cilat kishin për qëllim të e ngrisin vetëdijen e gjashtëdhjetë (60) pjesëmarrësve në lidhje me sigurinë në punën e përditshme të tyre në pesë (5) komuna: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Graçanicë and Lipjan. Gjithashtu, janë shpërndarë dhjetë (10) multikultivatorë për bartjen e mbeturinave bashkë me uniforma dhe pajisje tjera tek pesëdhjetë (50) përfitues. Në kuadër të këtij projekti, gjithashtu janë themeluar katër (4) qendra për mbledhjen e mbeturinave të recikluar në këto komuna: Fushë Kosovë, Lipjan, Obiliq, dhe Prishtinë. Këto qendra janë pajisur me mjete të nevojshme dhe si koordinatorë janë caktuar persona të cilët kanë kualifikime adekuat në këtë fushë.

ECMI Kosova gjithashtu ka organizuar bartjen e mbeturinave të mbledhura nga qendrat e e reciklimit deri tek kompanitë, me qëllim që të u lehtësojë punën në fillim të gjithë përfituesve të projektit. Në mënyrë që të krijohet një sistem i komunikimit dhe bashkëpunimit në mes të të gjitha qendrave të themeluara, përfituesve potencial dhe qendrave tjera të grumbullimit të mbeturinave apo grumbulluesve joformal të mbeturinave, ECMI Kosova u ka dhënë mbështetje teknike dhe u ka ndihmuar qendrave të themeluara të aplikojnë dhe të regjistrohet Asociacioni I Grumbulluesve joformal të mbeturinave “Iniciativa Kolektive për Reciklim në Kosovë (CRIK)”.

Në fund, si pjesë e projektit, është organizuar një kampanjë në të gjitha komunat e targetuara e cila kishte për qëllim të ngritë vetëdijen e qytetarëve për rëndësinë e klasifikimit të mbeturinave dhe përfitimet që mund të dalin nga ky veprim, kampanjë e cila ka arritur përafërsisht 5,000 persona (1,000 persona janë arritur në mënyrë direkte me anë të fletushkave dhe broshurave, kurse 4,000 janë arritur në mënyrë indirekte me anë të shpërndarjes së informatave në medime të ndryshme si webfaqja, facebook dhe llogaria ne twitter e ECMI Kosovës).

Për më tepër, në vitet e fundit në Kosovë janë bërë përpjekje nga akterë të ndryshëm për të përmirësuar gjendjen e grumbulluesve joformal të mbeturinave të cilë janë pjesëtarë të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Një prej këtyre përpjekjeve është projekti i Swisscontact “Mundësitë e gjenerimit të të ardhurave për komunitetin Rom përmes grumbullimit dhe reciklimit të mbeturinave të plastikës”. Në kuadër të këtij projekti, është nënshkruar një marrëveshje me një kompani për grumbullimin dhe procesimin e mbeturinave të plastikës, dhe pastaj është filluar dhe zgjeruar bashkëpunimi në mes të akterëve të përfshirë në marrëveshje. Fillimisht, akterët e përfshirë kanë investuar në blerjen e një makinerie të re e cila shtyp plastikën e llojit PET, inventim i cili ka siguruar të ardhura financiare për rreth 30 persona të komunitetit Rom që jetojnë në komunën e Graçanicës. Ky projekt gjithashtu ka për qëllim krijimin e mundësisë që klasifikimi i mbeturinave të bëhet në burim, dhe për të arritur këtë parasheh të përfshijë dhe të bëjë pjesë të këtij procesi edhe vet komunën e Graçanicës, komunë e cila është e targetuar në kuadër të projektit.

Projekt aktual i GIZ “Shërbimet Komunale të Qëndrueshme”, është projekt provues dhe përfshin vetëm tre (3) komuna të cilat bëjnë klasifikimin e mbeturinave të reciklueshme dhe pa-reciklueshme në burim, klasifikim ky i cili lehtëson shumë punën e grumbulluesve joformal të mbeturinave të cilët më pastaj mund të grumbullojnë vetëm mbeturinat të cilat mund t’i shesin. Ky projekt gjithashtu ka për qëllim edukimin e fëmijëve për rëndësinë e reciklimit të mbeturinave dhe të i inkurajojnë ata që këtë gjë të e praktikojnë në shtëpitë e tyre, duke u munduar të rrisin potencialin e klasifikimit në afat shkurtë dhe afat gjatë.

Përveç përfshirjes së drejtpërdrejtë të tyre në sektorin joformal të mbeturinave, organizatat tjera të shoqërisë civile u japin mbështetje dhe ndihmë grumbulluesve joformal të mbeturinave në forma të ndryshme si dhe inkurajojnë që personat e përfshirë në këtë sektor të shkollohen dhe të kërkojnë mundësi të tjera të punësimit pasi që sa më i lartë shkollimi, aq më pak do të shohim persona që punojnë si grumbullues joformal të mbeturinave shëndeti i të cilëve janë në rrezik çdo ditë.

## 5. ÇËSHTIJET E VAZHDOESHME

Edhe pas punës së madhe dhe rezultateve positive që janë arritur dhe arrihen nga kontributi i organizatave të shoqërisë civile, duke e përfshirë ECMI Kosovën, në këtë sektor, menaxhimi i mbeturinave dhe klasifikimi i tyre është në pozitë shumë të keqe. Për më tepër, grumbulluesit joformal të mbeturinave janë në pozitë shumë të keqe, të cilët kanë mungesë të kushteve elementare të punës dhe këmbimi që e marrin për këtë punë është shumë i vogël dhe i pamjaftueshëm për të u ofruar kushte mesatarë familjes. Edhe pse angazhimi i organizatave joqeveritare për të u dhënë mbështetje personave të përfshirë në këtë sektor ka qenë mjaft i madhë, numri i përfituesve direkt është i vogël në krahasim me numrin e përgjithshëm të personave që e bëjnë këtë punë në vazhdimësi në të gjithë territorin e Kosovës. Për të dal me një shifër të sakt të personave që punojnë si grumbullues joformal të mbeturinave në Kosovë është e vështirë, pasi që vet ata persona nuk dëshirojnë të deklarohen, regjistrohen apo licencohen për shkak të frikës së tyre. Për më tepër, është vërejtur që shumica e grumbulluesve joformal të mbeturinave nuk e bëjnë këtë punë në baza të rregullta, mirëpo angazhohen kur jetesa e tyre vështirësohet për arsye të ndryshme, duke e përfshirë edhe ndalimin e ndihmës sociale nga institucionet relevante shtetërore.

Varfëria me të cilën përballen grumbulluesit joformal të mbeturinave në Kosovë, të cilët e bëjnë këtë punë të ofrojnë mbështetje financiare familjeve të tyre, mund të jetë pengesë shumë e madhe që mos të ketë përparim të qëndrueshëm. Pa investime të vazhdueshme, është shumë e vështirë që grumbulluesit joformal të mbeturinave të veprojnë në bazë të organizuar dhe të pavarur. Nevoja e tyre për të mbijetuar nga dita në ditë i shpie ata tek përdorimi i fitimit për të u ofruar kushte elementare familjarëve të tyre, fakt ky i cili ndikon në zvogëlimin e mundësisë së investimit në ndonjë biznes të vogël apo afatgjatë dhe më të sigurt.

## 6. MUNDËSITË EKONOMIKE TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE NË KOSOVË

### 6.1 Masat për të përmirësuar reciklimin dhe të e mbrojmë ambientin

Materialet e recikluara të cilat eksportohen në shtete tjera sigurojnë rreth 40 milion Euro në vit për ekonominë e Kosovës. Edhe pse shihet që investimi në menaxhimin e mbeturinave dhe krijimi i një sistemi të rregullt të reciklimit mund të shihet si formë potenciale për Kosovën të rritë përfitimet, gjendja e riciklimit në Kosovës vazhdon të jetë e tmerrshme. Për më tepër, përfitimet nga eksporti i materialeve të riciklueshme mund të përdoren për të l fuqizuar dhe përmirësuar kushtet e punës grumbulluesve joformal të mbeturinave. Investimi në këtë industri nga shteti i Kosovës nuk do të krijojë vetëm mundësi të mëdha për përfitime ekonomike mirëpo kontribon edhe në mbrojtjen e mjedisit dhe e bën Kosovën një vend më të mirë për qytetarët e saj. Deponitë ekzistuese në Kosovë mbetet të jenë jashtëzakonisht johigjenike dhe të dëmshme për qytetarët e Kosovës dhe mjedisin.<sup>32</sup> Për këtë arsye, Kosova si shtet duhet të marrë masa të menjëhershme për të adresuar çështjen e përmirësimit të kapacitetit të klasifikimit të mbeturinave dhe reciklimin në Kosovë.

Për më tepër, Qeveria e Kosovës mund të fokusohet në identifikimin e potencialit që ka Kosova për të gjitha llojet e biomases, me anë të të cilave mund të prodhohet më pas energji, dhe të zvogëlojmë sasinë e energjisë së prodhuar nga termocentralet apo edhe të eliminojmë mundësinë e importit nga shtetet tjera.<sup>33</sup> Disa nga llojet të mbeturinave që gjinden në Kosovë mund të procesohen dhe në atë mënyrë të prodhohet energjia elektrike dhe më pas të ofrohet tek konsumatorët. Biomasa që krijohet në Kosovë nuk shkakton ndotje të mjedisit dhe nëse Qeveria e Kosovës investon në përdorim të duhur të saj, konsiderohet që të ketë potencial të jetë faktor shumë i rëndësishëm që do të ndikon pozitivisht në zhvillimin ekonomik të Kosovës.<sup>34</sup>

Megjithatë, në periudhën afatshkurte, Qeveria duhet të fokusohen në zgjidhjen e krizës së materialeve recikluese në Kosovë. Së pari, masa praktike për përmirësimin e reciklimit duhet të zbatohen nga Qeveria e Kosovës dhe organizatat e shoqërisë civile të cilat janë të specializuara në këtë fushë, për të bërë të mundur reciklimin në bazë më të gjërë. Kjo mund të ndodhë nëse mbeturinat fillojnë të ndahen në burim e cila më pas u a lehtëson punën grumbulluesve të mbeturinave të riciklueshme. Rrjedhimisht, mund të caktohen pika për hudhjen e mbeturinave të riciklueshme dhe të vendosen në vendet ku qytetarë e kanë më të lehtë të l hudhin ato.

<sup>32</sup>, BIRN paralajmëron për rreziqet e deponive në Kosovë: <https://balkaninsight.com/2018/05/25/mirash-landfill-an-environmental-catastrophe-in-kosovo-05-25-2018/>

<sup>33</sup>, Intervista me Ministren e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor Dr Albena Reshitaj

<sup>34</sup>, Energjia nga biomasa: <https://www.altenergymag.com/article/2009/08/biomass-wastes/530/>

Qëllimi kryesor i kësaj është të krijohet një sistem i grumbullimit të mbeturinave dhe të zhvillohet industria e reciklimit e cila gjithashtu mund të kontribuojë në zvogëlimin apo edhe zhdukjen e grumbullusve joformal të mbeturinave. Siç është cekur edhe në këtë raport shumë herë, kushtet në të cilat punojnë grumbulluesit joformal të mbeturinave janë shumë të vështira dhe nën çdo standard dhe Qeveria duhet sa më shpejtë të jetë e mundur të mendoj një strategji se si të zhduket ky problem. Megjithatë, nuk duhet të harrojmë që në këtë fushë, të përfshirë janë më së shumti grupen e cënuara dhe të marginalizuara në Kosovë, për të cilat Qeveria duhet të mendojë se si të përfshijë në industrinë e reformuar të grumbullimit dhe reciklimit të mbeturinave, nëpërmjet një mekanizmi institucional. Më shumë detaje për këtë, raporti do të paraqes në kapitullin më poshtë.

Masat praktike për të përmirësuar industrinë e reciklimit në Kosovë duhet patjetër të përcillen me kampanja vetëdijësuese të cilat kanë për qëllim ngritjen e vetëdijës së popullit të Kosovës për rëndësinë e reciklimit të mbeturinave dhe se si shteti i Kosovës mund të përfitojë nga këto. Mentaliteti i qytetarëve në lidhje me mbeturinat dhe reciklimin e tyre shihet si problematike në Kosovë, dhe ndryshimi i këtij mentaliteti duhet të fillojë të ndodhë. Iniciativa për të arritur këtë qëllim mund të fillojnë nëpër shkolla: fëmijët janë më të hapur për ide të reja, që do të thotë që nëse Kosova fillon me këto iniciativa apo aktivitete, brezat e ardhshëm do të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë dhe nevojën e klasifikimit dhe reciklimit të mbeturinave. Gjithashtu, fëmijë dihet që kanë fuqi të papërshtueshme që të kenë ndikim edhe tek të rriturit/familjarët e tyre.

## **6.2 Mundësitë e reja për grumbulluesit joformal të mbeturinave që mund të bëhen pjesë e Ndërmarrjeve Sociale në Kosovë**

Ndërmarrje sociale, e cila mund të definohet si “një entitet i cili ka për qëllim krijimin e vlerës sociale në vend të pasurisë personale dhe të investitorëve” nëpërmjet krijimit të “zgjidhjeve inovative që adresojnë problemet sociale ose mjedisore” mund të ofrojë një mekanizëm për të përmirësuar pozitën e grumbulluesve joformal të mbeturinave në Kosovë si dhe të ndihmojë të zgjidhë problemin apo krizat e sistemit të menaxhimit të mbeturinave dhe reciklimin e tyre. Ndërmarrjet Sociale janë në fazë të hershme të tyre në Kosovë të cilat së fundmi kanë filluar të përmenden si zgjidhje e mirë, kështu që edhe nëse ekzistojnë janë të vogla. Kjo edhe për faktin që Ligji Nr. 06/L-022 për Ndërmarrjet Sociale i Kosovës u miratua në vitin 2018. Me miratimin e këtij Ligji, Qeveria e Kosovës u ka dhënë ndihmë në mënyrë direkte grumbulluesve joformal të mbeturinave të cilët janë të interesuar të shfrytëzojnë të drejtat e tyre siç të cekura në Ligj.<sup>35</sup>

<sup>35</sup> Ligji për Ndërmarrjet Sociale në Kosovë: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18187>

Sipas Ligjit Nr. 06/L-022 për Ndërmarrjet Sociale në Kosovë, “ndërmarrje sociale” është “personi juridik pavarësisht mënyrës së themelimit, që në aktin e vet themelues i përmban objektivat sociale, kryen aktivitete ekonomike, bënë prodhimin e mallrave dhe ofron shërbime në interes të përgjithshëm të shoqërisë dhe i integron në punë personat nga grupet e cënueshme”.<sup>36</sup> Udhëzimi Administrativ për zbatimin e këtij ligji është thënë që do të miratohet në maj të vitit 2019, mirëpo ende nuk është bërë një gjë e tillë.

“Grupet e cënueshme” sipas po këtij Ligji “nënkupton kategorinë e personave të përkufizuar në këtë ligj si persona që kanë vështirësi për të u integruar në tregun e punës për arsye të ndryshme”,<sup>37</sup> të cilët konsiderohen të jenë të agazhuar në industrinë e grumbullimit joformal të mbeturinave. Për më tepër, Ligji thotë qëndërmarrjet sociale duhet të themelohen dhe udhëhiqen sipas këtyre principeve:

- Iniciativa e lirë;
- Kufizimi i shpërndarjes së përfitimit;
- Angazhimi në aktivitete sociale dhe tjera që për qëllim e kanë punësimin e grupeve të cënueshme në shërbim të interesit të përgjithshëm publik;
- Menaxhimi autonom;
- Vullnetarizmi;
- Respektimi i rregullave të tregut;
- Mos-diskriminimi në menaxhim dhe vendimmarrje;
- Pjesëmarrja e punonjësve dhe përfituesve;
- Transparenca e kontrollit.

Sipas Nenit 5 të këtij Ligji, ndërmarrjet sociale ndahen në dy kategori:

1) Ndërmarrjet Sociale të kategorisë A të cilat ofrojnë shërbime që garantojnë përfshirjen e personave të marginalizuar për përmirësimin e mirëqenies së tyre dhe zhvillojnë aktivitete në këto fusha:

- Asistencë sociale dhe mbështetje për strehim;
- Ndihma familjare dhe kujdes familjar;
- Shërbime shëndetësore dhe kujdes i infermierisë në shtëpi; O
- Ofrimi i shërbimeve ditore dhe kujdesi në shtëpi për personat me aftësi të kufizuara mendore, shqisore dhe fizike;
- Përkrahje dhe rehabilitim të personave me aftësi të kufizuara;
- Shërbime të kujdesit të përditshëm dhe kujdesit rezidencial për fëmijët me aftësi të kufizuara;

---

<sup>36</sup>. Ibid

<sup>37</sup>. Ibid

- Shërbime të kujdesit ditor në shtëpi dhe shërbime rezidenciale për personat e moshuar;
- Shërbimet që ofrohen për ri-integrimin e personave të dhunuar gjatë luftës;
- Shërbimet që ofrohen për ri-integrimin e viktimave të trafikimit, abuzimit dhe dhunës në familje dhe ri-integrimin e të rinjve delikuent;
- Shërbime dhe trajtime psikosociale të rasteve të abuzimit me substanca që shkaktojnë varësi;
- Arsimim dhe aftësim profesional dhe shërbime të transportit për personat me aftësi të kufizuara;
- Shërbime të punësimit, trajnimit dhe vetëpunësimit për grupet e cënueshme.

2) Ndërmarrje Sociale të kategorisë B janë ndërmarrjet që i punësojnë së paku tridhjetë për qind (30%) të punonjësve nga grupet e cënueshme dhe angazhohen në ofrimin e shërbimeve të dobishme për shoqërinë, apo në rritjen, përpunimin, prodhimin, procesimin e produkteve për shitje, dhe zhvillojnë aktivitete në këto fusha:

- Kultivimin, rritjen e erëzave, bimëve aromatike dhe mjekësore;
- Konservimin e frutave dhe perimeve nga ekonomitë familjare që i prodhojnë apo kultivojnë këto produkte në zonat rurale apo urbane;
- Prodhimin dhe përgatitjen e produkteve të prodhuara me dorë si puna e thurjes nga tekstilet, roba të punës dhe veshmbathje tjera të thurura me grep;
- Prodhimin dhe përgatitjen e produkteve për dekorim të bëra me dorë dhe me makinë;
- Përgatitjen apo prodhimin, mbështjelljen dhe paketimin e mjaltit, frutave, produkteve të perimeve apo produkteve tjera me origjinë bimore apo shtazore;
- Prodhimin, mirëmbajtjen e biçikletave, karrigeve, dhe pajisjeve tjera ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara;
- Mbledhjen, përpunimin, shkatërrimin e mbeturinave të parrezikshme dhe seleksionimin e tyre për qëllim të riciklimit;
- Mirëmbajtjen dhe kujdesin për hapësirat publike, monumentet e trashëgimisë kulturore dhe memorialët;
- Mirëmbajtjen dhe kujdesin për pyjet, drunjtë përgjatë rrugëve dhe bimët dekorative në hapësirat publike dhe parqet e ndryshme;
- Shërbimet dhe aktivitetet e turizmit, trashëgimisë kulturore dhe sektorin HOREC (Hotel, Restaurant, Caffe) me pjesëmarrje të kategorive të ndryshme sociale;
- Shërbime dhe aktivitete në trajtimin e kafshëve që konsiderohen si kërcënim për shëndetin publik dhe jetën e njeriut.<sup>38</sup>

<sup>38</sup>. Ibid

Sipas këtij Ligji, ndërmarrjet e tilla nuk janë fitimprusëse. Sipas Nenit 24 të Ligjit,“ fondet për zhvillim dhe promovim të ndërmarrjeve sociale, mund të sigurohen nga Buxheti i Kosovës dhe burimet tjera vendore dhe ndërkombëtare, kontributet e qytetarëve të vendit dhe të huaj, kompanitë private dhe organizatat ndërkombëtare.”<sup>39</sup> Ndërsa sipas Nenit 27, “pavarësisht nga forma e organizimit dhe aktivitetit që ato ushtrojnë, ndërmarrjet sociale përjashtohen nga tatimi në fitimin që ato e gjenerojnë gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tilla.”<sup>40</sup>

#### Ndërmarrje Sociale A

- Përfshirja e personave të cënuar
- Zhvillimi i aktiviteteve në fushat specifike

#### Ndërmarrje Sociale B

- Punësimi I të paktën 30% e personave nga grupen e cënuara

### *Ndërmarrje Sociale të tipit A dhe B*

Të dy tipet e ndërmarrjeve sociale mund të përdoren për të mbështetur grumbulluesit joformal të mbeturinave duke u ndihmuar atyre në mbledhjen e mbeturinave dhe në industrinë e reciklimit të bërë në formë të institucionalizuar. Një ndërmarrje sociale e tipit A mund të themelohet me qëllim të mbështesë individët benda komunitetit por jo domosdoshmërisht të ofrojë punë për ta. Ndërmarrjet e vogla lokale të cilat kanë makineri përpunuese mund të blejnë mbeturina me çmime të konsiderueshme nga grumbulluesit e mbeturinave dhe të i procesojnë ato para se të i shpërndajnë tek kompanitë më të mëdha apo eksportojnë. Ndërmarrjet sociale të kategorisë B mund të ndjekin një model të ngjashëm biznesi, mirëpo kanë mundësi edhe të i kontraktjnë grumbulluesit joformal të mbeturinave direkt, që mund të rrezultojë në punësimin “e më shumë se 30% të pesonave nga grupet e cënueshme”. Për më tepër, për të siguruar përfshirjen e grupeve të cënueshme në tregun e punës dhe për të krijuar mundësi për ta për të gjeneruar të ardhura, Komunitatet përkatëse mund gjithashtu të kërkojnë nga kompanitë komunale për grumbullimin e mbeturinave të regjistruhen nën kategorinë B të ndërmarrjeve sociale në mënyrë që grumbulluesit joformal të mbeturinave të përfshihen në strukturat formale të grumbullimit të mbeturinave.

Krijimi i ndërmarrjeve sociale për grumbullimin e mbeturinave të cilat janë të qëndrueshme në Kosovë, është një qëllim që Kosova duhet të i jep vetës. Për të arritur këtë qëllim, jo vetëm Qeveria e Kosovës por edhe organizatat e shoqërisë civile duhet të angazhohet dhe investojnë në këtë aspekt me qëllim të krijimit të mundësive për të marrë mbështetje financiare nga donator të ndryshëm.

<sup>39</sup>. Ibid

<sup>40</sup>. Ibid



Gjithashtu, për të krijuar ndërmarrje sociale të qëndrueshme duhet të angazhohen njerëz kompetent dhe të kualifikuar të cilët do të jenë përgjegjës për menaxhimin e tyre të cilët mund të kenë mbështetje të vazhdueshme nga organizatat e shoqërisë civile në Kosovë.

Për më tepër, shihet që ka një potencial që komunat e Kosovës të l kontraktojnë ndërmarrjet sociale në nivel lokal në mënyrë që ato të l japin mbështetje iniciativave të marra për reciklim të mbeturinave të cilat do të kontribuojnë në përmirësimin e efikasitetit të reciklimit në Kosovë dhe përfitimet e dala nga kjo industri të shpërndahen tek të gjithë qytetarët e Kosovës. Ndërmarrjet sociale mund të përfshihen në mbledhjen dhe klasifikimin e mbeturinave, me mbështetjen dhe duke e shfrytëzuar përvojën e grumbulluesit joformal të mbeturinave në këtë sektor.

## 7. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

### 7.1 Përfundimet

- Sistemi i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë mbetet shumë i dobët. Qeveria e Kosovës dhe institucionet përgjegjëse kanë dështuar në krijimin e një mekanizmi funksional i cili do të kishte kontribuar në koordinimin më efektiv të grumbullimi, klasifikimit dhe reciklimit të mbeturinave.
- Grumbulluesit joformal të mbeturinave luajnë një rol të rëndësishëm në sistemin e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë, të cilët materialet e vlefshme të grumbulluara i shesin për përfitime materiale. Në përgjithësi pozita në të cilën gjenden ata është reflektim i zbarztirave të legjislacionit ekzistues të Kosovës dhe zbatimit të tij. Neni 58 (4) i Kushtetutës së Kosovës obligon shtetin që "... sipas nevojës, të miratojë masa adekuate për të promovuar një barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore". Fatkeqësisht, barazia për disa komunitete siç janë komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë ende nuk është në nivelin e kënaqshëm. Për shembull, integrimi dhe pjesëmarrja e pjesëtarëve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në fusha të ndryshme në Kosovë është ende e limituar; për më tepër, situata financiare që ata kanë është shumë e vështirë dhe shumica prej tyre varen nga ndihmat sociale të dhëna nga shteti. Ky fakt gjithashtu ndikon në arsimimin e tyre dhe në braktisjen e shkollimit nga fëmijët të cilët detyrohen të futen në tregun e punës zakonisht në industritë joformale duke përfshirë edhe grumbullimin e mbeturinave, në mënyrë që të krijojnë të ardhura për të mbështetur familjet e tyre.
- Kapacitetet e grumbulluesve joformal të mbeturinave për të krijuar të ardhura janë shumë të vogla për disa arsye dhe të cilat janë: mungesa e një sistemi të koordinimit; paqëndrueshmëria e çmimeve që ofrohen nga kompanitë që blejnë mbeturinat e riciklueshme nga ta; mungesa e mjeteve për bartjen e mbeturinave; dhe mungesa e paisjeve për të e bërë këtë punë. Këto mungesa bëjnë që grumbulluesit joformal të mbeturinave të punojnë në kushte të vështira dhe të rrezikojnë shëndetin e tyre.
- Ekzistenca e deponive me standarde të ulëta, shkakton krijimin e sëundjeve të ndryshme dhe viruseve, ndotjen e tokës, ajrit, ujit dhe zvogëlon mundësinë e të pasurit bioversitet. Nëse këto deponi ekzistojnë për një kohë të gjatë, dhe shteti nuk merr asnjë masë për zvogëlimin e ndikimit të tyre, do të duhen shumë vite të largohen pasojat negative dhe kostoja do të jetë shumë e lartë për të stabilizuar situatën.

## 7.2 Rekomandime për krijimin e reformave për sektorin e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë

Në bazë të nevojave të grumbulluesve joformal të mbeturinave, shumica prej të cilëve janë pjesëtarë të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë, dhe të gjeturat që kanë dalur nga intervistat e bëra, ky raport sygjeron një numër të masave që duhet marrë që kushtet e grumbulluesve joformal të mbeturinave në Kosovë të përmirësohen.

- Në fillim, Qeveria e Kosovës duhet të vetëdijësohet që duhet të merren masa urgjente për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë. Situata momentale është shumë e keqe për disa arsye të cilat janë: 1) mbetjet të cilat mund të reciklohen dhe nuk bëhen, ndikojnë jashtëzakonisht keq në shëndetin e qytetarëve të Kosovës si dhe në mjedisin ku ata jetojnë; 2) zhvillimi i industrisë së reciklimit, gjegjësisht, reciklimi i mbeturinave të cilat grumbullohen në Kosovë, shihet si potencial mjaft i madhë në rritjen e ekonomisë së Kosovës, mundësi kjo e cila po neglizhohet nga Qeveria; 3) sistemi aktual është jashtëzakonisht i paqëndrueshëm dhe përbën shkelje të të drejtave të njeriut: grumbulluesit joformal të mbeturinave punojnë në kushte të rrezikshme, të pasigurta dhe marrin një kompensim jashtëzakonisht të dobët; shumë fëmijë janë pjesë e sistemit joformal të grumbullimit të mbeturinave, rrjedhimisht, u shkelen të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe ligje relevante.
- Materialet e riciklueshme në Kosovë eksportohen në shtete tjera dhe sjellin rreth 40 milion Euro për çdo vit, gjë që e bën këtë industry të jetë e para në rritjen e ekonomisë së Kosovës. Nesë shteti I Kosovës organizon dhe strukturon menaxhimin e mbeturinave, dhe fokusohet në krijimin e një sistemi efektiv të reciklimit të tyre, mund të rritet eksporti, rrjedhimisht të rritet edhe ekonomia e vendit. Një metodë e cila do të mund të përdorej është institucionalizimi I kompanive që bëjnë reciklimin e mbeturinave. Në të njejtën kohë, duhet të organizohen kampanja dhe aktivitete të ndryshme të cilat kanë për qëllim vetëdijësimin e qytetarëve përklasifikimin e mbeturinave nëburim në mënyrë që të u bëjnë punën më të lehtë kompanive të angazhuara në këtë sektor tëcilat i mbledhin këto mbeturina dhe I shesin tek kompanitë e reciklimit. Përfitimet monetare nga ky sektor, më pastaj mund tëpërdorën për krijimin e kushteve më të mira tëpunës për grumbulluesit e mbeturinave dhe të përmirësohet sistemi I menaxhimit të mbeturinave dhe reciklimi me qëllim të rritjes së eksportit të materialeve të riciklueshme e cila do të sjellë rritje ekonomike Kosovës.
- Duke investuar në industrine e reciklimit, shteti I Kosovës krijon më shumë vende të punës, e cila ndikon në zvogëlimin e numrit të papunësisë në vend. Ndërmarrjen sociale të tipin A dhe B, siç të përshkruara më lartë, mund të i mbështesin grumbulluesit joformal të mbeturinave me qëllim të arrijnë një sistem të

qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave dhe me qëllim të punësojnë persona nga grupet e cënueshme në Kosovë.

- Një çështje tjetër e rëndësishme me të cilën përballet Kosova është mbrojtja e mjedisit, i cili ndikon direkt në shëndetin e qytetarëve të saj. Reciklimi i mbeturinave, është një mënyrë shumë e mirë për të krijuar një ambient më të sigurt dhe pastër. Një nga metodat më të lehta dhe më pak të kushtueshme për të larguar mbeturinat, për të gjitha shtetet duke e përfshirë edhe Kosovën, është krijimi i deponive me standarde të larta, metodë kjo e cila në afatgjatë shkakton pasoja të mëdha ekologjike dhe në shëndetin e njeriut.
- Hapat të cilat mund të ndërmerren për të ngritur kapacitetin e reciklimit në Kosovës janë këto: krijimi i deponive të cilat i përmbushin standardet Evropiane të cilat do të kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit të cilat në asnjë mënyrë nuk do të ndikojnë negativisht në shëndetin e qytetarëve. Kjo mund të bëhet duke angazhuar ekspert të cilën e analizojnë ndikimin e krijimit të deponime në të gjitha aspektet në Kosovë dhe propozojnë vendin e krijimit të deponive.
- Legjislacioni i Kosovës është mjaft i avancuar, sipas standardeve Evropiane, mirëpo zbatimi i tij ka shumë ngecje. Kjo çështje duhet të adresohet dhe zbatimi dhe vlerësimi i ligjeve adekuate duhet të bëhet nga institucionet përgjegjëse.
- Përdorimi i materialeve që krijojnë biomasën mund të përdoret për prodhimin e energjisë. Ky hap do të adresojë dy problem njëherësh; 1) furnizimi efikas i energjisë do të përmirësohet dhe 2) mbetjet e pashfrytëzuara të materialeve nga mbeturinat do të shfrytëzohen. Shfrytëzimi i biomasës është ekologjikisht i shëndoshë dhe ekonomik, ku Kosova duhet të e konsiderojë potencial të rëndësishëm për të ardhmen.
- Një prej rekomandimeve më të rëndësishme, i cili patjetër që ndërlidhet me të gjitha çka u tha më lartë, është klasifikimi i mbeturinave në burim e cila do të u lehtësojë punën më pas grumbulluesve joformal të mbeturinave. Kjo mund të bëhet duke punuar shumë në ngritjen e vetëdijës së qytetarëve, me fokus të veçantë fëmijëve, për rëndësinë e klasifikimit të mbeturinave nëpër shtëpi. Këto iniciativa mund të bëhen edhe në kuadër të programeve shkollore ku fëmijët janë edhe grupi i parë i synuar.
- Organizimi i fushatave vetëdijësuese për rëndësinë e një mjedisi të pastër. Kjo mund të arrihet nëse të gjithë qytetarë e Kosovës angazhohen që të bëjnë klasifikimin e mbeturinave dhe të e vlerësinë rëndësinë e ripërpunimit të tyre dhe përfitimeve që shteti mund të ketë nga kjo industri. Edhe pse disa komuna veç se kanë organizuar kampanja të tilla, rekomandohet që ato duhet të zgjerohen

në tërë Kosovën dhe të organizohen në vazhdueshmëri për një periudhë më afatgjate.

- Në mënyrë që të krijohen reforma për sistemin e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë, mbështetje e vazhdueshme financiare dhe strategjike nevojitet nga aktorë të ndryshëm. Qeveria e Kosovës gjithashtu duhet të zotohet për të bërë reforma, e cila patjetër që do të ketë nevojë për mbështetje nga organizatat e shoqërisë civile ndërkombëtare dhe kombëtare të specializuara në këtë fushë. Edhe pse këto reforma kërkojnë edhe investime financiare siç e cekur më lartë, përfitimet që shteti i Kosovës mund të ketë në rrafshin ekonomik, social dhe në aspektin e shëndetit publik, tejkalojnë çdo investim të bërë.

## 8. REFERENCAT

- Ligji për mbeturinat Nr.04/L-060: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=28299>
- Agjensioni I Kosovës për mbrojtje nga mjedisi, Raporti Komunal për menaxhimin e mbeturinave, 2018, [https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Municipal\\_Waste\\_Management\\_in\\_Kosovo\\_Status\\_Report\\_2018.pdf](https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Municipal_Waste_Management_in_Kosovo_Status_Report_2018.pdf)
- BIRN paralajmëron për rreziqet e deponive në Kosovë: <https://balkaninsight.com/2018/05/25/mirash-landfill-an-environmental-catastrophe-in-kosovo-05-25-2018/>
- Veprimet e Bashkimit Evropian për të luftuar Krimin Mjedisor, Promovimi i BE-së për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë: [https://efface.eu/sites/default/files/EFFACE\\_The%20EUs%20promotion%20of%20environmental%20protection%20in%20Kosovo\\_revised.pdf](https://efface.eu/sites/default/files/EFFACE_The%20EUs%20promotion%20of%20environmental%20protection%20in%20Kosovo_revised.pdf)
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Strategjia e Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2022, [https://mmpk.rks-gov.net/repository/docs/Strategy\\_of\\_Republic\\_of\\_Kosovo\\_for\\_WM\\_2013-2022\\_eng\\_945753.pdf](https://mmpk.rks-gov.net/repository/docs/Strategy_of_Republic_of_Kosovo_for_WM_2013-2022_eng_945753.pdf)
- Ligji për vetë-qeverisjen lokale, Nr. 03/L-040, Neni 17. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>
- Agjensioni I Kosovës për mbrojtje nga mjedisi, Raporti Komunal për menaxhimin e mbeturinave, 2018, [https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Municipal\\_Waste\\_Management\\_in\\_Kosovo\\_Status\\_Report\\_2018.pdf](https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Municipal_Waste_Management_in_Kosovo_Status_Report_2018.pdf)
- Gjuetarët e mbeturinave: grumbulluesit e shfrytëzuar të skrapit në Kosovë: <https://balkaninsight.com/2019/02/11/scavenger-hunters-kosovos-exploited-scrap-collectors/>
- Kushtetuta e Kosovës: [http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se\\_Kosoves-2.pdf](http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se_Kosoves-2.pdf)
- Gjuetarët e mbeturinave: grumbulluesit e shfrytëzuar të skrapit në Kosovë: <https://balkaninsight.com/2019/02/11/scavenger-hunters-kosovos-exploited-scrap-collectors/>
- Sondazhi i publikuar nga ECMI Kosova, 2015: [http://www.ecmikosovo.org/uploads/Recycle%20ENG\\_preview.pdf](http://www.ecmikosovo.org/uploads/Recycle%20ENG_preview.pdf)
- Fondi Monetar Ndërkombëtar, Departamenti i Çështjeve Fiskale në Kosovë, Përmirësimi i Përfitimeve të Parave në Mbrojtje Sociale, mars 2016 <https://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2016/cr16123.pdf>
- Strategjia për përfshirjen e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, faqe 22
- Varfëria e konsumit në Kosovë: <http://ask.rks-gov.net/media/3187/poverty->

[report-2012-2015.pdf](#)

- Ligji I Punës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=27355>
- Konventa për të drejtat e fëmijës <http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AConRightsChild.pdf>
- Raporti i vlerësimit të zbatimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në shoqërinë Kosovare, 2017; [http://kosint2020.net/sq/lajme-dhe-ngjarje/raporti-i-vleresimit-te-zbatimit-te-strategjise-per-perfshirjen-e-komuniteteve-rom-dhe-ashkali-ne-shoqerine-kosovare-ne-vitin/Raport Tematik, Zbatimi i Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës, 2018.](http://kosint2020.net/sq/lajme-dhe-ngjarje/raporti-i-vleresimit-te-zbatimit-te-strategjise-per-perfshirjen-e-komuniteteve-rom-dhe-ashkali-ne-shoqerine-kosovare-ne-vitin/Raport%20Tematik,%20Zbatimi%20i%20Planit%20Strategjik%20t%C3%ABArsimit%20t%C3%ABKosov%C3%ABs,%202018)
- Punësimi I fëmijëve dhe punësimi I detyruar në Kosovë: [https://www.dol.gov/sites/dolgov/files/ILAB/child\\_labor\\_reports/tda2017/Kosovo.pdf](https://www.dol.gov/sites/dolgov/files/ILAB/child_labor_reports/tda2017/Kosovo.pdf)
- UNICEF, Monitorimi i situatës së fëmijëve dhe grave 2013-2014: [file:///C:/Users/ECMI/Downloads/ddi-documentation-english\\_microdata-2536%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/ECMI/Downloads/ddi-documentation-english_microdata-2536%20(1).pdf)
- UNICEF. Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë: Anketa e Grupeve me Treguesve të shumëfishtë 2013-2014. Prishtinë: [https://www.unicef.org/statistics/index\\_24302.html](https://www.unicef.org/statistics/index_24302.html)
- UNICEF, Punësimi I fëmijëve në Kosovë: Studim për fëmijët e punësuar: [https://www.unicef.org/kosovoprogramme/kosovo\\_media\\_pub\\_prot.008.04.pdf](https://www.unicef.org/kosovoprogramme/kosovo_media_pub_prot.008.04.pdf)
- Gazeta Express Artikull: Qentë mbysin 5-vjeçarin në Fushë Kosovë – banorët rrëfejnë për tmerrin <https://www.gazetaexpress.com/lajme/qente-mbysin-5-vjecarin-ne-fushe-kosove-banoret-rrefejne-per-tmerrin-foto-67335/?archive=1>
- ONP: Ndalimi i punës së fëmijëve në Kosovë: Le të jenë fëmijët fëmijë. Shkurt 9, 2015: [http://www.ilo.org/global/about-the-ilo/newsroom/features/WCMS\\_343157/lang--en/index.htm](http://www.ilo.org/global/about-the-ilo/newsroom/features/WCMS_343157/lang--en/index.htm)
- Kombet e Bashkuara, Lufta kundër Punës së Fëmijëve duke fituar momentin në Kosovë, thotë Agjencia e OKB, 2015 <https://news.un.org/en/story/2015/02/490572>
- BIRN paralajmëron për rreziqet e deponive në Kosovë: <https://balkaninsight.com/2018/05/25/mirash-landfill-an-environmental-catastrophe-in-kosovo-05-25-2018/>
- Intervista me Ministren e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor Dr Albena Reshitaj
- Energjija nga biomasa: <https://www.altenergymag.com/article/2009/08/biomass-wastes/530/>
- Ligji për Ndërmarrjet Sociale në Kosovë: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=181877>









4 European  
Union  
Kosovo

 **ERAC**  
EQUAL RIGHTS FOR ALL COALITION

